

VENDIM
Nr. 513, datë 30.6.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT NR. IV NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT, DHE
DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT (GIZ)
GMBH, SI PËRFAQËSUESE E QEVERISË GJERMANE DHE AGJENCI
ZBATUESE, PËR PROGRAMIN “ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK
DHE RAJONAL, NXITJA E PUNËSIMIT DHE ARSIMI DHE FORMIMI
PROFESIONAL” (PROSEED)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit nr. IV ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për programin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit dhe formimi profesional” (ProSEED), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE ZBATIMI Nr. IV

ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

- në vijim e referuar si "partner zbatues"

dhe

**Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn

-në vijim i referuar si "GIZ" -

në lidhje me programin

" Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e
Punësimit dhe Arsimit dhe Formimi Profesional" (ProSEED)

- në vijim i referuar si "programi"-

MARRËVESHJE PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE TË BASHKËPUNIMIT TEKNIK

Përmbajtja

Bazat e Marrëveshjes

1. Objektivi dhe indikatorët e Programit

2. Kontributet për Programin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-

it

2.1 Sigurimi i ekspertëve

2.2 Furnizimi i materialeve dhe pajisjeve

2.3 Kostot operative dhe administrative

2.4 Kontribute të tjera

3. Kontributet nga Organizatat Partnere

3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

3.2 Kostot

3.3 Sigurimi i objekteve, ndërtesave dhe mjediseve të punës

4. Dispozita të tjera

4.1 Vlerësimi

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes

4.3 Afati i Marrëveshjes

4.4 Përshtatja e Marrëveshjes

4.5 Forma me shkrim

4.6 Marrëveshjet me organizata zbatuese individuale

4.7 Zbatimi i Marrëveshjes

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

4.9 Hyrja në fuqi

5. Shtojcat

Bazat e Marrëveshjes

Teksti i mposhtëm do të përbëjë bazën e kësaj Marrëveshjeje:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988 (shihni Shtojcën 1)
- Ligji Nr. 11/2018 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin "Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimit dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), të miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5.03.2018", (shihni Shtojcën 2).
- Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 60/2021, datë 26 mars 2021 dhe Protokolli i Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020. (shih Shtojcën 3)

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 2 të Marrëveshjes së lartpërmendur; Paragrafi 3, Neni 2 i ligjeve Nr. 11/2018; detajet e programit duhet të përcaktohen në një marrëveshje ndërmjet GIZ-it dhe Organizatës Partnere MFE. GIZ është duke vepruar në përmbushjen e mandatit me të cilën është ngarkuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

1. Objektivi dhe indikatorët e Programit

Objektivi i këtij Programit është: **Situata e punësimit në Shqipëri është përmirësuar, duke përfshirë elementët dixhitalë dhe të gjelbër.**

Programit do të zhvillojë aktivitetin në nivel kombëtar, në të gjitha rajonet e Shqipërisë.

GIZ dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë si partner zbatues kyç angazhohen bashkërisht për të arritur këtë objektiv.

Indikatorët e objektivit janë:

Treguesit objektivë janë:

- 1,100 të diplomuar/certifikuar nga masat e modernizuara të kualifikimit profesional janë të punësuar ose të vetëpunësuar; 450 prej tyre janë gra dhe 220 emigrantë të kthyer.
- 1,500 vende pune janë siguruar apo krijuar rishtas në 850 ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) të mbështetura në fushat e digjitalizimit dhe zhvillimit të gjelbër ekonomik.
- Elementë kryesorë të një strategjie apo plani të ri veprimi në lidhje me digjitalizimin ose zhvillimin e gjelbër ekonomik, që synon përmirësimin e gjendjes së punësimit, janë miratuar nga organet përkatëse politike vendim-marrëse.

Rezultatet e përgjithshme të programit përfshijnë: (1) përmirësimin e ofertës së fuqisë punëtore të kualifikuar, (2) përmirësimin e konkurrencës së MSME-ve dhe kapacitetin e tyre për krijimin e vendeve të punës, (3) mbështetjen e zhvillimit të politikave në fushat e AFP-së dhe Zhvillimit të Sektorit Privat, integrimin e dixhitalizimit dhe ekonomisë së gjelbër në të gjitha aktivitetet. Tre fushat e ndërhyrjes do të përmbajnë masat kryesore të mëposhtme:

Fusha e Ndërhyrjes 1 (AFP): Të përmirësojë ofertën e fuqisë punëtore të kualifikuar në sektorët me potencial të lartë punësimi, duke integruar sistematikisht në sistemin AFP-së elementët digjitalë dhe të gjelbër nëpërmjet kurrikulave mësimore si dhe zbatimin e tyre në kualifikimin profesional formal dhe jo formal. Masat do të përfshijnë për shembull: (a) ngritjen e kapaciteteve për ofruesit publikë dhe privatë të APS-së për mbështetjen e ofrimit e formimit profesional me cilësi të lartë, (b) zhvillimin e programeve të reja ose rishikimin e kurrikulave ekzistuese duke integruar elementët e gjelbër dhe digjitalë; c) trajnimin e personelit të AFP-së, d) zbatimin e mëtejshëm të planit digjital dhe (e) pilotimin e zhvillimit të aftësive të gjelbra (në profesione shumë të rëndësishme). f) mbështetja e ofruesve publik të AFP-së me pajisje të TIK-ut për të mundësuar lëvrimin e kurrikulave të reja; dhe çështjet e gjelbërta (p.sh. parandalimi i mbeturinave, riciklimi dhe eliminimi i sigurt, përdorimi efikas i energjisë dhe ujit, shëndeti dhe siguria në punë).

Fusha e Ndërhyrjes 2 (ZhSP): Rritja e konkurrencës së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), për të siguruar vendet ekzistuese ose për të krijuar vende të reja pune. Kjo përfshin përdorimin e potencialit të zhvillimit dixhital dhe të gjelbër për të rritur përdorimin e proceseve dhe menaxhimit, mbështetur në modernizimin e teknologjisë dhe informacionit. Ndërsa në zhvillimin e biznesit të gjelbër

NMVM - pavarësisht nga sektori – proceset e biznesit duhet të mbështeten në qasje miqësore ndaj mjedisit. MSM-të do të përfshihen në zbatimin e masave të gjelbërta ose futjen e elementëve digjitalë me grante financimi të forcuara nga projekti. Përveç kësaj, elementët thelbësorë të zbatimit të strategjisë BIDS 2021-2027 do të mbështeten (duke përfshirë zhvillimin e marrëdhënieve të furnizimit, qasjet grumbulluese) për të integruar NMVM-të në zinxhirët rajonalë ose evropianë të vlerave. Organizatat e përfaqësimit dhe mbështetëse të NMVM-së do të fuqizohen me këshillim mbi zhvillimin e qëndrueshëm, të gjelbër dhe dixhital të biznesit.

MSM-të e goditura nga krizat e Kovidit do të mbështeten për të kapërcyer vështirësitë dhe për të përshtatur me sukses modelet e biznesit për t'u bërë elastike, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt të ardhmes e ndaj kushteve të reja të tregut.

Fusha e Ndërhyrjes 3 (Mbështetja e Zhvillimit të Politikave): Mbështetje MFE, AKPA, AKAFPK, dhe AIDA për të zhvilluar politika të reja, strategji dhe për të përmirësuar kushtet kornizë për integrimin e digjitalizimit dhe elementëve të gjelbër në zhvillimin e Sektorit Privat, Punësimin dhe Aftësi Profesionale për të rritur zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe punësimin. Masat do të përfshijnë: (a) zhvillimin e elementëve të zgjedhur të strategjisë së re SKPA 2022-2027, (b) analiza sektoriale për VET në sektorin e gjelbër / gjelbërimin e AFP-se, (c) mbështetje për monitorimin e BIDS 2021-2027, dhe (d) mbështetjen e zhvillimit të politikave në fushat e digjitalizimit dhe ekonomisë së gjelbër.

Të gjitha veprimtaritë do të synojnë meshkuj e femra të rritur si dhe të kthyerit që vijnë nga Gjermania dhe vende të tjera anëtare të BE.

2. Kontributet për Programin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

Në përputhje me:

Protokollin e Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020 dhe Shkëmbimit të Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë Shqiptare VN-Nr.: 60/2021, të datës 26 mars 2021, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i ofron GIZ-së për zbatim vlerën deri në 8.5 milionë Euro (me fjalë tetë milion e pesëqind mijë Euro). Kjo shumë do të përfshijë shpenzimet e bëra nga Organizata Gjermane e Zbatimit.

Buxheti i përgjithshëm i programit ProSEED arrin vlerën 33.65 milion Euro. Një tabelë që përshkruan të gjitha alokimet buxhetore është bashkëngjitur si Shtojca 4 e kësaj Marrëveshjeje Zbatimi.

Kohëzgjatja e përgjithshme e programit është planifikuar deri në 30/09/2025. Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit do të mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej gjashtë muajsh, deri më 31/03/2026 për të siguruar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumenteve të projektit tek pala partnere.

2.1 Sigurimi i ekspertëve

GIZ do të vërë në dispozicion për programin:

- një ekspert ndërkombëtar përgjegjës për kontributin e GIZ i cili në të njëjtën kohë do të jetë menaxher/udhëheqës i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion të këtij programi për të gjithë kohëzgjatjen e tij.
- ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushat e:

- Arsimit dhe formimit profesional me fokus në bashkëpunimin me (i) ofruesit publikë dhe privatë të formimit profesional, (ii) integrimin e aspekteve digjitale dhe të gjelbërta në sistemin AFP-së dhe (iii) këshillim mbi politikë;
- Zhvillimit të Sektorit Privat me fokus në (i) shërbimet e këshillimit dhe trajnimet e sipërmarrjes për të ndërtuar kapacitetet e NMVM, (ii) promovimin dhe zbatimin e projekteve të investimeve me fokus zhvillimin rajonal, (iii) këshillim mbi politikë;
- Monitorimit të programit, Raportim dhe aktivitete informuese e promovionale.
- Menaxhimit të zyrës me detyra administrative dhe logjistikë;
- Shërbime mbështetëse për zyrat e programit.

Periodha e kohore e punës për ekspertët e huaj përfshin edhe lejet vjetore në përputhje me dispozitat e ligjit gjerman.

2.2 Furnizimi i materialeve dhe pajisjeve

GIZ do të furnizojë artikujt e mëposhtëm për të pajisur infrastrukturën teknike:

- o Përdorimin e automjeteve të projektit (të blera në fazën e mëparshme të programit);
- o Mobilje, pajisje dhe infrastrukturë komunikimi për zyrat e programit në Tiranë;
- o Pajisje të reja dhe/ose përdorimi i pajisjeve ekzistuese për ofrues të zgjedhur publikë të AFP-së;
- o Pajisje të reja për organizatat partnere të nevojshme për arritjen e objektivave të programit.

Këto pajisje, pas përfundimit të përdorimit nga programi GIZ, do të transferohen në institucionet partnere përkatëse.

2.3 Kostot operative dhe administrative

GIZ do të mbulojë kostot operacionale dhe/ose administrative që lidhen me administrimin e kontributit gjerman për Programin.

2.4 Kontribute të tjera

GIZ do të japë kontributet shtesë të mëposhtme:

- o Sipas buxhetit vjetor dhe nevojave konkrete të partnerëve, GIZ do të ofrojë konsulencë për zhvillimin e kapaciteteve të partnerëve, grupeve të synuara, ndërmjetësve dhe aktorëve të tjerë kryesorë në nivel kombëtar dhe mikro, për zhvillimin dhe menaxhimin e njohurive në fushat specifike të ndërhyrjes ose objektivave të programit. Shërbimet e konsulencës do të dakordësohen midis GIZ dhe institucioneve të saj partnere.
- o Përdorimi, nëse konsiderohet i nevojshëm i instrumenteve të GIZ-it për zbatim, si Kontratat e Konsulencës (lokale dhe ndërkombëtare), Marrëveshjet Financiare, Subvencionet Lokale dhe Kontratat (lokale dhe ndërkombëtare) për shërbimet dhe mallrat, pajisjet dhe /ose mbështetjen e konferencave, seminareve për çështjet e lidhura me programin.
- o Zbatimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere.
- o Kontribute të tjera në përputhje me planin e operacional të programit.

3. Kontributet nga Organizatat Partnere

3.1 Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

Organizata Partnere Zbatuese duhet:

- o të sigurojë përfaqësimin e duhur nga MFE dhe agjencitë përkatëse ekzekutuese, në Komitetin Drejtues Politik (KDP) të programit. Të organizojë dhe thërrasë takimin e KDP të paktën dy herë në vit, duke përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e Minutave të Takimit për të gjithë pjesëmarrësit. Një përfaqësues i ambasadës gjermane do të jetë gjithashtu i pranishëm në KDP.
- o të sigurojë një interlokutor të kualifikuar të Ministrisë për programin në nivel teknik për menaxhimin e përditshëm të programit, i cili gjithashtu mund të këshillojë strategjikisht programin.
- o të vënë në dispozicion stafin partner të kualifikuar për të marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e programit.
- o të sigurojë pjesëmarrjen e stafit nga MFE dhe agjencitë ekzekutuese në masat e ndërtimit të kapaciteteve.

3.2 Kostot

Organizatat partnere, do të sigurojnë kostot e TVSH-së për aktivitetet e programit që përfitojnë institucionet e tyre përkatëse dhe shpenzimet e lidhura me të në Shqipëri (shpenzimet operative dhe prokurimet) si dhe për prokurimet/importet ndërkombëtare. Sigurimi i buxhet të mjaftueshëm deri në datën e përfundimit të programit 31.03.2026. Angazhimi për të rimbursuar TVSH-në është i vlefshëm për të gjithë periudhën e zbatimit të programit.

3.3 Sigurimi i objekteve, ndërtesave dhe mjediseve të punës

Organizata partnere (MFE) duhet:

- o të vërë në dispozicion të Programit pa pagesë (nëse është e mundur) si dhe përdorimin e ambienteve dhe sallave të konferencës duke përfshirë pajisjet për të kryer aktivitetet dhe trajnime që lidhen me programin.
- o të vërë në dispozicion hapësirat dhe ndërtesat e ofruesve publikë të AFP-së, laboratorët, pajisjet dhe orënditë përfshirë edhe ato pajisje që nuk janë blerë nga GIZ nëse është e nevojshme për zhvillimin e aktiviteve që lidhen me programin ProSEED komponenti i AFP-së.

4. Dispozita të tjera

4.1 Vlerësimi

GIZ mund të ndërmarrë një vlerësim të Programit gjatë ose pas zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, GIZ do të nënkontrakttojë ekspertë/vlerësues për Programin. Organizatat Partnere do të marrin pjesë në vlerësim. Në të gjitha rastet do të ndihmojnë ekspertin(ët)/vlerësuesin(ët) në punën e tyre dhe do t'i lejojnë ata për të shqyrtuar të gjitha dokumentet e nevojshme.

Organizata partnere do të informohen për rezultatet e vlerësimit me anë të raporteve.

4.2 Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes

GIZ mund të pezullojë kontributin e saj nëse:

- o Organizata Partnere nuk arrin të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet në lidhje me këtë Marrëveshje, ose
- o linden rrethana, të cilat përjashtojnë apo rrezikojnë ndjeshëm objektivin e Programit të përshkruar në Klauzolën 1 më sipër.

Nëse lind një nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 më sipër dhe ekziston ende pas një afati të rënë dakord nga GIZ-i me Organizatën Partnere ose nëse nuk eliminohet brenda kësaj periudhe, GIZ-i, me pëlqimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund të përfundojë para kohe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4.3 Afati i Marrëveshjes

Përveç kur parashikohet në Klauzolën 4 më sipër mbi pezullimin e kontributeve dhe përfundimit të Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për kohëzgjatjen e fazës vazhduese të Programit (aktualisht i planifikuar të vazhdojë deri në 30/09/2025). Ndërkohë, Marrëveshja e Zbatimit do të mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej tre muajsh, deri më 31/03/2026 për të mundësuar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumentacionit të përshtatshëm tek organizata partnere. Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet në rast të vonesave në zbatimin e kontributeve të palës gjermane sipas termave të shkruar në Marrëveshjen Zbatimin dhe kontributeve të dakordësuara të Organizatës Partnere. Zgjatja e afatit të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të gjitha palët e përfshira.

4.4 Përshtatja e Marrëveshjes

Nëse dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndihmojnë në arritjen efikase të objektivit të përcaktuar në Klauzolën 1 më sipër, atëherë GIZ-i dhe Organizat Partnere mund të përshtasin ose ndryshojnë këto dispozita me pëlqim të ndërsjellë në çdo fazë gjatë zbatimit të programit. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim.

GIZ mund të përfundojë në mënyrë të njëanshme këtë Marrëveshje, nëse mandati me të cilin është ngarkuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, është tërhequr.

4.5 Forma me shkrim

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si edhe deklaratat dhe komunikime të tjera të rëndësishme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, do të jetë e mjaftueshme që të merren nga drejtuesi i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion.

4.6 Marrëveshjet me organizata zbatuese individuale

Personi përgjegjës për kontributin nga GIZ-i dhe personin (at) përgjegjës për kontributet nga organizata partnere ose organizata të tjera zbatuese mund të lidhin bashkërisht një marrëveshje detyruese për detaje shtesë në lidhje me ekzekutimin e programit (p.sh. në bazë të një plani të veprimeve), ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme për të përcaktuar ato detaje me shkrim dhe, kur është e nevojshme, për të përshtatur ndonjë marrëveshje të tillë për të marrë parasysh zhvillimet e programit.

4.7 Zbatimi i Marrëveshjes

Në lidhje me dispozitat që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, referencë do të bëhet me dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik (shihni Shtojcën 1) dhe Marrëveshjen/Shkëmbimin e Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për angazhimet në lidhje me bashkëpunim teknik (shihni Shtojcën 3), të dyja të përmendura në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve, rekomandohet që të zgjidhet me anë të bisedimeve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje e tillë, komunikimi duhet të ndiqet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

4.9 Hyrja në fuqi


Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përbushjes së procedurave të brendshme të palëve. Ajo hartohet në katër kopje origjinale: dy në gjuhën angleze dhe dy në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e tekstit, gjuha angleze do të ketë përparësi.

Tiranë, 10.05.22

GIZ



Znj. Sonja Kurz
Drejtor i Përgjithshëm



Znj. Irina Kausch
Drejtuese Programi

Këshilli i Ministrave i Republikës së
Shqipërisë


Znj. Delina Ibrahimaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

nr. prot. 3485/12 6.6.2022

5.Shtojcat

Shtojca 1: Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988.



Annex1 Agreement
1988_FRG and GOA.d

Shtojca 2: Ligji No. 11/2018 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për projektin "Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimit dhe Formimi Profesional", miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5.03.2018.

LIGJ
Nr. 11/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK 2017, PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK DHE RAJONAL, NXITJA E PUNËSIMIT DHE ARSIMI PROFESIONAL (SHTIMI I DYTË FONDESH)"

Në mbështetje të nenëve 73, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin "Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtimi i dytë fondesh)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.3.2018

Shpallur me dekreten nr. 10741, datë 12.3.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2017

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekonomike miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe për t'i thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik si partnerë;

të ndërgjegjshëm se nxitja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

Shtojca 3: Notë Verbale 60/2021, datë 26 mars 2021, dhe Protokoli i Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020.



21-03-26-VN-NR-60
-ProSEED(002).pdf



TIRA_2020-11-27_48
268_Anlage_01_Signe

Shtojca 4: Përmbledhje e alokimeve buxhetore për ProSEED

Marrëveshje Qeveritare (Notë verbale)	Akt ligjor	Marrëveshje ndërmjet partnerëve zbatues	Buxheti
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik të datës 26 shtator 2016 dhe 23 janar 2017.	Ligji Nr. 59/2017 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimit dhe Formimi Profesional", miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 20 prill 2017	Marrëveshja e Zbatimit ndërmjet GIZ ZKM, MMSR, dhe MZHTTS 19/06/2017	5.5 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik të datës 26 shtator 2016 dhe 23 janar 2017.	Ligji Nr. 60/2017 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimit dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 20 prill 2017"	Marrëveshja e Zbatimit ndërmjet GIZ ZKM, MMSR, dhe MZHTTS 19/06/2017	5 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik të datës 26 shtator 2016 dhe 23 janar 2017.	Ligji Nr. 11/2018 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin " Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimit dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5 Mars 2018.	Amendim i Marrëveshjes bazë të Zbatimit Nr. 1, ndërmjet GIZ ZKM, dhe MFE 19/12/2017	6 milion Euro
Instrumente për Para-Aderim (IPA II)	Marrëveshje me Delegacionin e Bashkimit Evropian (ctr. 2018/400-907) me Organizatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH dhe Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) për zbatimin e fondit deri në 4.4 milion Euro (katër pikë katër milion Euro).	Kontratë Numër 2018/400-907 24/09/2018	4.4 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për	Ligji Nr. 11/2018 për Ratifikimin e Marrëveshjes me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin "	Marrëveshje Zbatimi II, ndërmjet GIZ dhe MFE 21/12/2019	3 milion Euro

Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 314/2018, të datës 30 nëntor 2018.	Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga Parlamenti Shqiptar në 5 mars 2018.		
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 146/2020, datë 28 korrik 2020, dhe VN-Nr.: 38/2021, datë 17 shkurt 2021	Marrëveshje me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin "Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar nga qeveria shqiptare me VKM Nr. 631 date 27.11.2021.	Marrëveshje Zbatimi III, ndërmjet GIZ dhe MFE	1.25 milion Euro
Shkëmbimi i Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik VN-Nr.: 60/2021, datë 26 mars 2021 dhe Protokolli i Negociatave mbi Bashkëpunimin e Zhvillimit midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbajtur më 24 nëntor 2020	Marrëveshje me anë të Shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Programin "Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimi dhe Formimi Profesional" (shtim fondesh), miratuar qeveria shqiptare me VKM. Nr. 262, datë 29.04.2022.	Marrëveshje Zbatimi IV, ndërmjet GIZ dhe MFE	8.5 milion Euro
Totali i programit ProSEED			33.65 milion Euro